



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

### PROCESVERBAL I përmbledhur<sup>1</sup>

Tiranë, më 22.12.2020, ora 14.00

**Drejton mbledhjen -  
Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit**

#### **Rendi i Ditës :**

*1. Shpallja e fillimit të procedurës së vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve në vendin vakant në gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.*

*2. Relatimi për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidaturës së kandidatëve të lejuar:  
-Altin Binaj.  
-Aleksandër Toma.  
-Përparim Kalo.*

*3 .Zhvillimi i intervistës me kandidatët e lejuar për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur vakancë e parakohshme, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, si më poshtë:  
-Aleksandër Toma.  
-Përparim Kalo.*

*4. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja për kandidatët e lejuar.*

*5. Diskutimi dhe miratimi i listës përfundimtare të renditjes, si dhe i raportit përkatës.*

---

<sup>1</sup> Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226, pika 1, shkronja “d”, neni 232, pika 2, neni 242, shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funksionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED-së për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe të subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED-ja disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhjeje, sipas ligjit.

**Marrin pjesë:**

- |                     |               |
|---------------------|---------------|
| 1. Vitore Tusha     | (zv/kryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare)     |
| 3. Arta Marku       | (anëtare)     |
| 4. Miranda Andoni   | (anëtare)     |
| 5. Saida Dollani    | (anëtare)     |
| 6. Ludovik Dodaj    | (anëtar)      |
| 7. Fatjona Memçaj   | (anëtare)     |

**Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme:**

1. **Erinda Ballanca**, Avokate e Popullit.

**Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:**

1. **Bledar Dervishaj**, përfaqësues me autorizim i Presidentit të Republikës.
2. **Katrin Treska**, përfaqësuese me autorizim e Presidentit të Republikës.
3. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë.

**HAPET MBLEDHJA**

**Vitore Tusha** hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës që është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Fton anëtarët të miratojnë rendin e ditës.

**Anëtarët** miratojnë rendin e ditës.

**Vitore Tusha** vijon mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës, fillimi i procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të z. Altin Binaj, z. Aleksandër Toma dhe z. Përparim Kalo, vakancë e parakohshme për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020. Sqaron se për këtë vakancë janë ankuar vetëm dy nga të ndaluarit z. Hasanaj dhe z. Mone paditë e të cilëve janë rrëzuar dhe vendimet e tyre kanë marrë formë të prerë.

Fton anëtarët të miratojnë fillimin e kësaj procedure.

**Anëtarët** miratojnë vendimin për fillimin e procedurave të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendin vakant të shpallur nga Presidenti i Republikës.

**Vitore Tusha** vijon relacionin për kandidatin e lejuar z. Altin Binaj, duke sqaruar se në relacionin e përcjellë anëtarëve pasqyrohen të gjitha veprimet që ka kryer Këshilli i Emërimeve në Drejtësi dhe se me vendimin nr.77 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë z. Altin Binaj është zgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese dhe po ditën e sotme është zhvilluar ceremonia e betimit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

**Mimoza Arbi** merr fjalën dhe shton se vendimi është botuar edhe në Fletoren Zyrtare.

**Vitore Tusha** sqaron gjithashtu, se z. Altin Binaj ka dorëzuar një deklaratë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi ku heq dorë nga kandidimi për vakancën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese në pozicionin e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, për shkak të papajtueshmërisë së këtij kandidimi me detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Sqaron se ky fakt nuk pasqyrohet në relacionin e shpërndarë nga relatorja pasi ai është përpiluar më parë. Sqaron se deklarata e z. Altin Binaj është bërë pas betimit të tij si gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese dhe se ajo është protokolluar me numër 539 protokoll dhe mban datën 22.12.2020.

Pyet nëse ka pyetje apo sqarime.

**Erinda Ballanca** shprehet se nuk ka pyetje dhe për sa kohë ka një vullnet të kandidatit për të hequr dorë nga kandidimi në këtë vakancë në vendimmarrjen e Këshillit do ta gjente me vend që të prevalonte pikërisht fakti që ndërpritet procedura e vlerësimit për këtë kandidat për shkak të dorëheqjes së tij nga kandidimi.

**Vitore Tusha** fton anëtarët të votojnë në lidhje me këtë çështje.

**Anëtarët** tërhiqen për vendim.

*Ndërpritet mbledhja.*

*Rifillon mbledhja.*

**Vitore Tusha** rifillon mbledhjen.

Evidenton se në mbledhje ka ardhur përfaqësuesi i Presidentit z. Bledar Dervishaj dhe se znj. Katrin Treska largohet nga mbledhja.

Në cilësinë e relatores bën raportimin për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidatit të lejuar, z. Aleksandër Toma. Parashtron në mënyrë të përmbledhur relacionin e vlerësimit për kandidatin z. Aleksandër Toma për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës të shpallur me datë 07.02.2018, rishpallur më datë 27.09.2019 dhe përsëri rishpallur me datë 24.09.2020. Sqaron se relacioni i është njoftuar kandidatit dhe u është shpërndarë anëtarëve të Këshillit dhe të ftuarve.

Pyet nëse anëtarët dhe Avokaten e Popullit kanë ndonjë pyetje ose koment.

**Anëtarët dhe Avokatja e Popullit** nuk kanë pyetje ose komente.

**Vitore Tusha**, në cilësinë e relatores, vijon me raportimin për procedurën e ndjekur për vlerësimin e kandidatit të lejuar, z. Përparim Kalo. Parashtron në mënyrë të përmbledhur relacionin e vlerësimit për kandidatin z. Përparim Kalo për vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës më datë 07.02.2018, rishpallur më datë 27.09.2019, dhe përsëri rishpallur më datë 24.09.2020. Sqaron se relacioni i është njoftuar kandidatit dhe u është shpërndarë anëtarëve të Këshillit dhe të ftuarve.

Sqaron se të dy kandidatët janë njoftuar të jenë prezent në orën 14:30 në ambientet e KED për të zhvilluar intervistën.

Pyet anëtarët dhe Avokaten e Popullit nëse ka ndonjë pyetje ose koment.

**Anëtarët dhe Avokatja e Popullit** nuk kanë pyetje ose komente

**Vitore Tusha** vijon me pikën e tretë të rendit të ditës, intervista me kandidatët e lejuar.

Sipas rendit të ditës fillohet me z. Aleksandër Toma dhe ftohet kandidati.

I bëhet me dije kandidatit se është thirrur për të prezantuar platformën e tij para Këshillit.

**Aleksandër Toma** shpreh falënderimet e tij dhe ndihet shumë i vlerësuar që ndodhet para një organi kaq të nderuar por dhe për faktin që kandidon në atë vend aq të nderuar dhe me aq vlerë.

Parashtron platformën e tij para Këshillit.

**Vitore Tusha** pasi falenderon z. Aleksandër Toma për evidentimin e sfidave që ka përpara Gjykata Kushtetuese pas gati tre vitesh të mosfunksionimit të saj dhe aftësinë e tij për të kapërcyer këto barriera, shprehet se: “Ju avantazhon fakti që keni më shumë se 9 vite në Gjykatën Kushtetuese, aty ku ushtrohet dhe veprimtaria dhe i di nga brenda të gjitha problematikat.”

Fton anëtarët të bëjnë pyetje nëse kanë.

**Saida Dollani** merr fjalën dhe falënderon kandidatin për platformën që shpalosi në mënyrë të përmbledhur. Shprehet se ka për të bërë një pyetje në lidhje me integritetin etik dhe moral të kandidatit që vlerësohet dhe me pikë. Ju bëtë një shpjegim paraprak për të kuptuar nëse me nevojitet të di në lidhje me karrierën tuaj. Një nga pikat që parashikohet në metodologji është detyrimi i ndershmërisë dhe korrektësisë e respektit dhe metodologjia listohet nga shkronja A në shkronjën Ç. Pra çfarë kandidati duhet të këtë bërë apo të mos të këtë bërë. Duke parë një evolucion të karrierës tuaj, kini filluar si ndihmës gjyqtar dhe aktualisht jeni drejtor kabinetit, pra

karriera është me një progresivitet në rritje. Në ç'mënyrë është bërë transferimi apo emërimi? Është bërë mbi baza konkurruese?

**Aleksandër Toma** falënderon për pyetjen dhe shprehet se është kënaqësi të përgjigjet pasi është një pyetje që për të vlen shumë. Integriteti i kandidatit duhet të plotësoj të gjithë elementet e duhura të atij që fillimisht e mendon ti futet kësaj gare dhe domosdoshmëri etike, dhe këtë e kam menduar mirë që në fillimin e kësaj gare. Të them të drejtën, kjo pikë nuk më ka ceduar asnjëherë në karrierën time, jam shumë i lumtur për këtë dhe shumë krenar sepse gjatë gjithë karrierës time të punësimit qoftë dhe njëherë të vetme nuk më ka thirrur asnjë epror, qoftë dhe për të më këshilluar në lidhje me mosplotësimin e detyrave. Fatmirësisht kjo dhe për shkak të sjelljes time që ka vazhduar deri sa jam ulur në atë karrige që jam edhe sot. Dhe unë e konsideroj të lidhur pazgjdhshëmrisht ose më mirë të them si një kriter themelor që janë të lidhur me kriteret e tjera. Unë nuk e di se sa kam arritur që të plotësoj në këtë pyetje që ju me drejtoni me dokumentacionin që kam sjellë. Por jam munduar të marr nga gjithsecili që nga fillimi i marrjes së punës si kryetar i Gjykatës së Lezhës, i cili më bëri një pyetje: “Aleksandër mund të të vlerësoj unë sot që kam qenë gjyqtar në kohën që ti ke qenë kryetar se ndoshta është një kohë shumë e gjatë”? Unë i thashë, ti do më pasqyrosh në vlerësimin tënd gjithçka kujton si ato që lidhem ndoshta me ato pjesë që unë e di që nuk janë por të ti dhënë sadopak kurajo dhe për ato që ti mendon që janë për tu vlerësuara. Deri te i fundit titullari i Gjykatës Kushtetuese, i cili madje duke hezituar për momentin më tha: “Aleksandër unë po ta bëj sepse unë kam shumë shkrime për ty po do shkruaj gjërat që me kujtohen.” Me këtë dua të them që vlerësimi për punën time ka qenë gjithmonë me superlativa nga të gjithë titullarët dhe kjo më ka dhënë mua një shtytje dhe nxitje për punën dhe për tu përfshirë në këtë garë vlerën dhe peshën e saj të cilën unë e di shumë mirë. E vetmja gjë që më mundon është që a do mundem unë, nëse do ulem në atë karrige, që ta përmbush me sukses atë siç e kam përmbushur në gjithë karrierën time ndaj detyrës time.

**Ludovik Dodaj** falënderon z.Toma për prezantimin e tij përpara Këshillit dhe e pyet se çfarë lënde ka dhënë në universitetin “Motrat Qirjazi”.

**Aleksandër Toma** përgjigjet se ka dhënë një lëndë shumë specifike që është “E Drejta e Konkurrencës”, për të cilën ka nxjerrë dhe disa materiale që i ka referuar dhe se është një lëndë që e ka dhënë me shumë kënaqësi.

**Vitore Tusha** pyet kandidatin se cili ishte motivimi kryesor që e nxiti të konkurrojë për një mandat të shkurtër.

**Aleksandër Toma** shprehet se ka shumë motive por po përmend dy që janë më kryesoret. E para është besimi në veten time për shkak të karrierës time shumë të gjatë në administratën e lartë publike por dhe në sistemin gjyqësor pra, një besim në një përvojë të konsoliduar për ta përmbushur me sukses atë detyrë. E dyta është detyrimi që ndiej unë personalisht duke pasur parasysh karrierën time për tu futur në një garë që po vuante prej dy vjetësh për mungesë kandidatësh. Mendova të jem një ndër tyre sepse i kam të gjithë elementët e duhur dhe besim në vete për të qenë i tillë.

**Vitore Tusha** falënderon kandidatin z. Aleksandër Toma.

Vijon mbledhjen me intervistën e kandidatit të lejuar z. Përparim Kalo.

Ftohet kandidati për t'u dëgjuar nga Këshilli në lidhje me platformën e tij.

**Përparim Kalo** falënderon Këshillin dhe parashtron platformën e tij.

**Vitore Tusha** parashtron pyetje për kandidatin. Ju keni më shumë se 26 vjet që ushtroni profesionin e avokatit pavarësisht spektrit të gjerë të cilin ju keni zhvilluar veprimtarinë tuaj, qoftë e lidhur me avokatinë apo me propozimet në nismat legislative në këto fusha dhe në shkrimet që keni bërë. Ju keni mbajtur gjithmonë një pozicion të njëanshëm, po jo të njëanshëm politikisht, të njëanshëm në funksion të klientëve tuaj, pra duke qenë avokat gjithmonë ke për detyrë ose më saktë është etike e detyrueshme që t'i shërbesh klientit. Ndërkohë që roli që ju synoni ose detyra për të cilën ju kandidoni kërkon një pozicionim tjetër, që të jetë i pavarur në ushtrimin e veprimtarisë, të mos jetë i varur nga individët, nga interesat që lidhen me

personalitetin dhe që lidhen me interesa të ndryshme. Sa mendoni që cilësitë që ju keni do ta shpalosin këtë detyrim, i cili shdërrohet si i tillë në momentin që ju emëroheni si gjyqtar.

**Përparim Kalo** përgjigjet se në fillim kur thashë jam pjesë e sistemit, “pjesë e teatrit” ishte jo në kuptimin e keq, por në të gjithë asaj që i duhet një procesi qoftë pjesë e konsulencës qoftë dhe paraqitjes para gjykatës. Nëse dikush është nga njëra anë nuk mendoj se është problem të jetë dhe nga ana tjetër ose në mes. Siç është e njëjta gjë dhe për gjyqtarët që largohen duke ushtruar profesionin e avokatit dhe kalojnë nga njëra anë pak a shumë inversi i pyetjes tuaj. Por mendoj se nuk kam ndonjë shqetësim që të gjej pozicionin tim. Kjo ka të bëjë me atë që ke në mendje, me atë që ke dëshirë të bësh dhe me aftësinë që besoj që s’kam përse mos e gjej pozicionin në mes, pozicionin e çekiçit le të themi.

**Vitore Tusha** pyet nëse kolegët kanë pyetje.

**Saida Dollani** shprehet se e dëgjoi platformën e kandidatit, ku u pohua që ka punuar në aktivitet privat dhe bazuar dhe në ligjin për avokatinë është pjesë e sistemit dhe në funksion të drejtësisë. Shprehet se, në anën tjetër, profesioni i avokatit mundëson për tu angazhuar në çështje të kauzave të drejtave të njeriut ose për angazhime në shoqërinë civile dhe pyet nëse ka kandidati një përvojë të tillë.

**Përparim Kalo** përgjigjet: “Mendoj që ka ndryshuar pak koncepti për të drejtat e njeriut në kontekstin e veprimtarisë se gjykatës pra rrethi i çështjeve dhe i subjekteve është zgjeruar e përherë më shumë kemi parë që të përfshihen dhe subjekte siç janë shoqëritë tregtare, sepse tashmë gjithçka vërtitet tek procesi i rregullt, procesi ligjor. Kjo nuk e ka përjashtuar interesin tone për tu marrë me të drejtat e njeriut për ti mbrojtur në proces. Sa i përket shoqërisë civile unë them që ne kemi mbështetur çështje shumë problematike siç është çështja e Valbonës, ne kemi qenë dhe jemi avokatë të shoqatës Toka e cila mbron mjedisin. Përveç asaj unë personalisht, por dhe zyra, kemi përqafuar çdo iniciativë që ka të bëjë me komunitetin. Ne jemi themeluesit e parë të CSR (përgjegjësia sociale e korporatave) bashkë me 4 kompanitë më të mëdha, me emër Vodafone, Titan, BKT, Intracom dhe zyra jone dhe kemi investuar duke themeluar për herë të parë një institucion i cili është lidhur dhe me institucionet evropiane netëork-un e gjere të CSR e cila ju shërben komuniteteve aty ku veprojnë shoqëritë anëtare të saj. Edhe ne si zyrë avokatie që nuk kemi aktivitet siç ka Titani, në fushën e industrisë së çimentos, kemi kontribuar duke rritur integritetin profesional, duke ju shërbyer komunitetit në fusha të tjera kështu që them se kam se çfarë të flas për këtë pjesë por ndoshta duhet ti shfletoj materialet pasi është një dosje shumë voluminoze me ato që kam referuar”.

**Vitore Tusha** falenderon kandidatin dhe fton Këshillin të tërhiqet për të vazhduar me vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

Deklaron të mbyllur seancën e mbledhjes së Këshillit dhe njofton se mbledhja do të vijojë ditën e mërkurë, datë 23.12.2020, ora 10.00.

**Mbyllet mbledhja në orën 15.36.**

**Tiranë, më datë 22.12.2020.**

**Vijon mbledhja e Këshillit.**

**Vitore Tusha** hap mbledhjen e thirrur në datën 22.12.2020 që vijon dhe në datën 23.12.2020 dhe verifikon paraprakisht praninë e anëtarëve dhe të ftuarve.

Vijohet me pikën e fundit të rendit të ditës, që është pikëzimi i kandidatëve dhe sqaron se pikëzimi i kandidatëve është përfunduar dhe janë përgatitur projektvendimet për secilin nga kandidatët e vlerësuar, të cilat u janë shpërndarë anëtarëve për të përfshirë në to dhe sugjerimet e tyre. Projektvendimet përmbajnë të gjitha ato kushte dhe kriteret që ligji parashikon për këtë fazë të vlerësimit dhe metodologjisë së nxjerrë në përputhje me vendimin nr. 5 të Këshillit.

Ftohen anëtarët për të miratuar projektvendimet sipas radhës, duke filluar me projektvendimin për pikëzimin e kandidatit z. Aleksandër Toma.

Pyet Avokaten e Popullit nëse ka ndonjë vërejtje paraprake.

**Erinda Ballanca** shprehet se nuk ka vërejtje.

**Anëtarët** miratojnë vendimin për pikëzimin e z.Aleksandër Toma.

**Vitore Tusha** fton anëtarët të miratojnë projektvendimin e paraqitur nga relatorja për kandidatin z.Përparim Kalo.

Pyet Avokaten e Popullit nëse ka ndonjë vërejtje paraprake.

**Erinda Ballanca** shprehet se nuk ka vërejtje.

**Anëtarët** miratojnë vendimin për pikëzimin e z.Përparim Kalo.

**Vitore Tusha** merr fjalën dhe shprehet se vendimet e miratuara janë gati për tu redaktuar dhe për tu bashkangjitur të gjithë dokumentacionit përkatës.

Vijon me çështjen tjetër të rendit të ditës, diskutimi dhe miratimi i listës përfundimtare të renditjes. Sqaron se nga vendimmarrja e mbledhjes së djeshme që u konkretizua me vendimet e sapomiratuara, kualifikimi i të dy kandidatëve të lejuar është konkretisht: Përparim Kalo 90.23 pikë dhe Aleksandër Toma 75.57 pikë. Kjo është shumatorja e mesme e të gjithë anëtarëve të Këshillit dhe mbi këtë bazë është përpiluar akti i cili i rendit kandidatët, pra kandidatin Përparim Kalo të parin dhe kandidatin Aleksandër Toma të dytin, sipas pikëve që ata kanë marrë nga vlerësimi i anëtarëve të Këshillit.

Fton anëtarët që bazuar në këto kritere të miratojnë listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, si më poshtë: Përparim Kalo 90.23 pikë dhe Aleksandër Toma 75.57 pikë.

**Anëtarët** miratojnë listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve.

**Vitore Tusha** vijon me rendin e ditës dhe sqaron se në përputhje me kriteret ligjore pas miratimit të listës përfundimtare duhet të miratohet dhe raporti për renditjen e kandidateve të lejuar për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese. Sqaron se në projektraportin e përgatitur, i shpërndarë me e-mail, përshkruhet e gjithë procedura e ndjekur për këtë vakancë që nga shpallja në datën 07.02.2018 dhe rishpallja më pas në shtator të 2019 dhe në shtator të 2020, ajo çfarë ka ndodhur me secilin kandidat, sa herë është rishpallur dhe gjithë dokumentacioni shoqëruar bashkëlidhur. Po ashtu, në mënyrë të detajuar përshkruhet e gjithë procedura e ndjekur pas rishpalljes së fundit dhe në këtë procedurë gjejnë pasqyrim të gjithë vendimmarrjet e Këshillit për secilin nga kandidatet, për kandidatet e tërhequr, të ndaluar dhe për kandidatet e lejuar. Në të gjenden vendimet përkatëse të Gjykatës së Apelit, e cila ka rrëzuar kërkesën e ankimuar nga z.Hasanaj dhe z. Mone. Të gjitha sa më sipër janë pjesë e raportit të shpërndarë dhe se në të nuk gjen pasqyrim vetëm vendimmarrja e sotme e Këshillit, të dhëna që do t'i shtohen këtij akti menjëherë pas përfundimit të kësaj mbledhje.

Fton anëtarët të miratojnë projektraportin për renditjen e kandidatëve të lejuar.

**Anëtarët** miratojnë raportin për renditjen e kandidatëve të lejuar.

**Vitore Tusha** pyet nëse Avokatja e Popullit si vëzhguesja që monitoron në çdo aspekt ka ndonjë vërejtje lidhur me procedurën e ndjekur.

**Erinda Ballanca** përgjigjet se nuk ka asgjë në lidhje me vendimmarrjen por shprehet se do të ishte e këshillueshme që Këshilli të kishte pasur mundësi të dërgonte të paktën 3 kandidatë, çëshje e cila do të trajtohet edhe në raportin e përgjithshëm të këtij organi për punën e Këshillit. Nuk ka qenë në vullnetin e Këshillit por ka qenë në gjykimin tim me pjesëmarrjen time këtu, ku dhe kam identifikuar faktin se kjo ka qenë përtej mundësive të Këshillit për të çuar një listë të plotë me tre kandidatë në organin e emërtesës. Sigurisht kuptoj dhe organin e emërtesës, i cili i ka bërë me dije Këshillit se nuk do ta rishpalli me këtë vakancë për shkaqet tërësisht objektive të cilat janë të paraqitura edhe në komunikimet e paraqitura me shkrim. Mendoj se kjo vakancë duhet të dërgohet në organin e emërtesës siç edhe Këshilli e ka marrë vendimin, në mënyre që të procedohet sa më parë, që t'i jepet mundësia këtij organi të shprehë vullnetin e tij për emërimin e anëtarit të ri të Gjykatës Kushtetuese.

**Vitore Tusha** merr fjalën dhe shprehet se Presidenti i Republikës si organ emërtesë i kësaj vakante e ka deklaruar me shkrim faktin që Kqshilli duhet të veprojë dhe t'i dërgojë listën në situatën që është. Ky është një vullnet i shprehur i tij. Në këtë proces është në vlerësimin e organit të emërtesës që konsiderojë nëse ka ose jo mundësi ta ushtrojë të drejtën e zgjedhjes. Shprehet se Këshilli ka vepruar në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe me ligjin në të gjithë këtë procedurë, si dhe me opinionin e Komisionit të Venecias.

Falënderon të gjithë pjesëmarrësit për bashkëpunimin e dhënë dhe njofton se brenda ditës së sotme i gjithë dokumentacioni do t'i dërgohet organit të emërtesës.

Deklaron mbledhjen të mbyllur.

**Mbyllet mbledhja në orën 10.50.**

**Tiranë, më datë 23.12.2020**

**ZËVENDËSKRYETARE**

**Vitore TUSHA**